

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtarja e çështjes Fatime Dëramku me zyrtaren ligjore Edona Grajçevci, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. D., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.798/14 të datës 25.03.2016, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datë 06.12.2017, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, prokurorit të shtetit Fatmire Cacaj dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. D., i biri i Sh. dhe nënës S., e vajzërisë M., i lindur me *data e lindjes...*, në fsh.L., KK.P. ku edhe tani jeton, me nr. personal *numri personal...*, me nr. të tel. *Numri i telefonit...*, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i punësuar në agjensionin B., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 16.01.2014, rreth orës 15:42h, në P., në rrugën "...", i pandehuri pas një mosmarrëveshje të atëçasshme, me dashje e me qëllim të shkakimit të lëndimit trupor, e sulmon fizikisht të dëmtuarin B. K., në atë mënyrë që, me duar e kap për fyti e duke e shtrënguar, dhe me kokë e godet kokën e tij, me ç'rast i dëmtuari, ka pësuar lëndime të legta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara më për së afërmi në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 17.07.2015,

- **Me çka ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 të KPRK-së.**

Prandaj gjykata në bazë të nenit 7, 17, 21, 41, 49, 85, 74 të KPRK-së dhe neneve 365, 366 të KPPRK-së, i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Me këtë vërejtje i bëhet me dije të akuzuarit **A. D.**, se e ka kryer veprën penale dhe nëse përsëritet vepër tjetër penale gjykata do t'i shqiptoi dënim më të rëndë penal.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25.00€, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.798/14 të datës 25.03.2016, me të cilën ka akuzuar A. D., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 të KPRK-së.

Me datë 06.12.2017, gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar lidhur me këtë çështje juridike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, prokurorja e shtetit Fatmire Cacaj dhe i akuzuari A. D.. Pas leximit të akuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit u pajtua me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Meqenëse pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit ishte i plotë dhe bindës dhe se pohimi i tij për veprën penale të kryer përputhej në tersi me provat tjera që gjinden në shkresat e lëndës, të gjitha këto në mënyrë të plotë dhe të argumentuar e vërtetojnë gjendjen faktike, gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë së tij.

Meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej, gjykata nuk bëri administrimin e provave, por vazhdoi me matjen e dënimit.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të vërtetuar faktike, me rastin e matjes së dënimit, llojit dhe lartësisë së tyre gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në vështrim të nenit 41 të KPRK-së e të cilat janë me ndikim me rastin e individualizmit të dënimit, ashtu që rrethana rënduese për të pandehurin nuk gjeti kurse si rrethane lehtësues për të pandehurin mori faktin se asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar, se e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkonte akuza, si dhe duke pasur parasysh deklaratën e Prokurores së Shtetit e cila deklaroi: pasi që i pandehuri është i gjendjes së rëndë ekonomike, e pasi që edhe ka sjellë kartonin për asistencë sociale, është mbajtës i familjes 5 anëtarëshe, i propozojmë Gjykatës, t'i shqiptoj vërejtje gjyqësore, duke konsideruar se i pandehuri ka qenë edhe i provokuar nga sjelljet e të dëmtuarit, edhe me këtë masë do të arrihet qëllimin i dënimit, andaj gjykata vlerësoi se edhe pa shqiptimin e ndonjë dënimi por vetëm me vërejtjen e shqiptuar gjyqësore mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarit që t'i paguaj paushallin gjyqësor u muar konform nenit 456 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor është marrë në bazë të nenit 456 të KPPRK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
P.nr.1448/16, me datë 06.12.2017

Procesmbajtësja
Edona Grajçevci

Gjyqtarja
Fatime Dërmaku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.